



Duke u bazuar në nenin 43, 45 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, Nr.03/L-040, nenin 47 të Statutit të Komunës së Klinës Nr. 01-110-1232/2010. Nenin 5 të Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës si dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bën këtë:

F T E S Ë

Ftohen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe të interesuarit e tjerë që të marrin pjesë në seancën e **VIII-të të rregullt të punës së kuvendit për vitin 2026.**

Seanca mbahet më **25.09.2026 (e Premte)**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës dhe fillon në orën **10:00.**

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së. Për këtë seancë propozohet ky:

R E N D I I D I T Ë S

1. Arsyetimi i mungesave;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 31.07.2026;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa nga mbledhjet e mbajtura më datë 17.08.2026 dhe 09.09.2026;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Drejtorisë për Arsim për ndarjen e bursave për studentë dhe formimin e Komisionit për ndarjen e bursave (ref. Drejtoria për Arsim);
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të DUMM-së për ndarjen e parcelave dhe ndryshimin e destinimit të shfrytëzimit të tokës për ndërtimin e objektit të banimit social (ref. DUMM)
6. Shqyrtimi i raportit nga procesi i dëgjimeve buxhetore lidhur me draft-buxhetin e Komunës së Klinës për vitin 2027 (ref. Grupi Punues);
7. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-buxhetit për Komunën e Klinës për vitin 2027 (ref. EKZ);
8. Informatë rreth ofrimit të shërbimeve komunale ndaj mërgimtarëve gjatë sezonit veror 2026 (ref. Drejtoria e Administratës);
9. Informatë lidhur me përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2026–2027 (ref. Drejtoria e Arsimit);
10. Pyetje dhe përgjigje.

01Nr. 06-30011 /2026
Klinë, me 14.09 /2026



Kryesuesi i Kuvendit,
Enver Berisha